



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 66, datë 29.04.2025**

**MBI**

**MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST”  
SH.A., DHE TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR  
RAIFFEISEN, ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 76/2023 DHE RREGULLOREVE NË  
ZBATIM TË TIJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 202, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe neneve 62 dhe 63, të Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Raiffeisen INVEST-shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Miratimin e përshtatshmërisë së Fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Raiffeisen, me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**